



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 06.02.2019]

Për: Operatorin Ekonomik “Bami” shpk, me NIPT J94416206R, me adrese: Kameras – Fushe Kruje - Durres.

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Ndertim I ures se Zeze dhe mbrojtje nga permbytjet te qytetit Fushe Kruje”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndertim I ures se Zeze dhe mbrojtje nga permbytjet te qytetit Fushe Kruje”**.

Numri i referencës së procedurës: **REF-96102-11-27-2018**.

Kohëzgjatja: brënda 14 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 384.683.580 (treqind e tetëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 04.01.2019**.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	NIPTI	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	"DELTA LAVORI" SPA	L62415021P	283,005,206
	"COMPANY RIVIERA 2008" SHPK	K81716011V	
	"AGRI KONSTRUKSION" SHPK	K01725001F	
2	"VELLEZERIT HYSA" SHPK	K12911201C	328,346,057
3	"BAMI" SHPK	J94416206R	368,248,045
4	"GJOKA KONSTRUKSION" SHPK	J91815014U	371,123,618
5	"4AM" SHPK	K92005016L	371,181,563
6	"LALA" SHPK	J76418903B	375,842,744
	"SHANSI INVEST" SHPK	J61924002T	

7	"CURRI" SHPK	J67902718S	379,942,987
8	"KEVIN KONSTRUKSION" SHPK	K71401004W	PA OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje shoqerine “Vellezerit Hysa” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me deklarimin e mosangazhimit te stafit pasi ne deklarate nuk shprehet se punonjesit jane te pa angazhuar ne pune te tjera ne proces, por “do te jene te pa angazhuar”. Duke qene se nga tabela e puneve qe kjo shoqeri ka deklaruar se ka ne proces rezulton se ka ne proces kater pune me vlera te konsiderueshme, rezulton se stafi i kesaj shoqerie eshte i angazhuar dhe nuk ploteson kerkesen per kualifikim.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me punesimin e inxhinierëve pasi per pozicionin e inxhinierit te ndertimit me profilin struktura ka deklaruar ing. Bashkim Ali me te cilin ka lidhur kontrate punesimi ne daten 16.03.2016, me afat 10 vjecar, por emri i tij nuk figuron ne listepagesat e paraqitura per muajt janar tetor 2018.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.5 per kualifikim lidhur me pervojat e meparshme qe duhet te kene inxhinieret qe do te punojne per zbatimin e objektit, pasi ing. Mjedisit Olkida Naci nuk ka asnje pervoje ne punime zbatimi ne ndertim.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.6 per kualifikim lidhur me deklarimin e mosangazhimit e inxhinierëve pasi ne deklarate nuk shprehet se inxhinieret jane te pa angazhuar ne pune te tjera ne proces, por “do te jene te pa angazhuar”. Duke qene se nga tabela e puneve qe kjo shoqeri ka deklaruar se ka ne proces rezulton se ka ne proces kater pune me vlera te konsiderueshme, rezulton se inxhinieret e kesaj shoqerie jane te angazhuar dhe, ne kete menyre, nuk ploteson kerkesen per kualifikim.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.10 per kualifikim lidhur me deklarimin e mosangazhimit te mjeteve dhe paisjeve pasi ne deklarate nuk shprehet se mjetet jane te pa angazhuar ne pune te tjera ne proces, por “do te jene te pa angazhuar”. Duke qene se nga tabela e puneve qe kjo shoqeri ka deklaruar se ka ne proces rezulton se ka ne proces kater pune me vlera te konsiderueshme, rezulton se mjetet e kesaj shoqerie jane te angazhuara dhe, ne kete menyre, nuk ploteson kerkesen per kualifikim.

2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Lala” shpk (42.09%) dhe “Shansi Invest” shpk (57.91%) pasi:

Shoqeria “Shansi Invest” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me stafin pasi ka marre persiper punime ne strukturat e betonit te ures dhe nuk ka te punesuar ing ndertimi me profilin struktura, sic kerkohet ne kerkesat per kualifikim.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

3. Te skualifikoje shoqerine “Kevin Konstruksion” shpk pasi: Nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per kualifikim.

4. Te skualifikoje Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Delta Lavori" Spa (66,87%) & "Company Riviera 2008" Shpk (17,37%) & "Agri Konstruksion" Shpk (15,75%) per arsye se nuk paraqiti argumentime per oferten anomalisht te ulet te paraqitur ne tender

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik "Bami" shpk**, me me NIPT J94416206R, me adrese: Kameras – Fushe Kruje - Durres, se oferta e paraqitur, me vlerë **368,248,045 (treqind e gjashtedhjetë e tete milion e dyqind e dyzet e tete mije e dyzet e pese) lekë** pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. "Sami Frashëri", Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t' i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **29.01.2019**.

Afatet e ankimit kane perfunduar dhe per proceduren nuk jane paraqitur ankesa.